



« Eja! Mos e
bej legjende! »

FYTYRAT E SHUMELLOJSHME TE DHUNES NDAJ GRAVE.

Permbledhje *Asgje nuk justifikon dhunen* 02 *Fytyrat e shumellojshme te dhunes ndaj femrave* 04 *Cikli i dhunes brenda çiftit bashkeshortor* 06 *Dhuna nje rreth vicioz* 10 *Kjo nuk i arrin vetem te tjereve* 14 *Si t'ia dalesh mbane* 16 *Ngacmimi i perditshem* 17 *Dhuna nuk eshte nje çeshtje private !* 18 *Ligji i 8 shtatorit 2003 mbi dhunen shtepiake* 20 *Pastaj ?* 22
Kujt t'i drejtohesb ? 23-24



**MBARUAN
KOMPROMISET**

Kunder dhunes ndaj
grave dhe vajzave

PARATHENIE

Juve mbani ne duar versionin e ri te broshures

« Fytyrat e shumellojshme te dhunes ndaj femrave ».

Profesionistet, qe punojne çdo dite me femrat dhe femijet e keqtrajtuar, kane pershtatur botimin e pare te broshures. Kjo ishte e nevojshme per dy arsye : Ne njeren ane kerkesa e madhe per variantin e pare te kesaj broshure,te mbaruar nderkohe dhe nga ana tjeter hyrja ne fuqi e ligjit mbi dhunen shtepiake.

Ky ligj parashikon largimin nga shtepia te personit qe ka ushtruar dhunen. Konstatimi pas dy vjetesh na nxit qe te mendojme. Per nje popullsi pak a shume 460000 banore, ka 13 largime ne muaj mesatarisht. Per me teper, çdo muaj, rreth 20 femije perballen me dhunen shtepiake ne kuadrin e ketyre largimeve.

Ti besh balle dhunes shtepiake eshte nje nga kushtet per te arritur ne nje barazi te vertete midis femrave dhe meshkujve ne shoqerine tone.

Shpresoj qe versionin e ri te broshures, qe tregon qarte dhunen, do te munde te ndihmoje nje numer te madh grash dhe burrash ne perpjekjet e tyre per te dale nga rrethi vicioz qe perben dhunen shtepiake.

Marie-Josée Jacobs

Ministre e Barazise se Shanseve

ASGJE NUK JUSTIFIKON DHUNEN

DHUNA NDAJ FEMRAVE KA FYTYRA TE SHUMELLOJSHME. « Eja! Mos e bej legjende! » Ky lloj arsytimi qe kerkon te qetesoje pas nje rasti, te themi, qe nuk te vret, eshte krejt i pavend. Ne fakt dhuna fillon atje ku viktimat ndihen te poshteruara, te neperkembura, te plagosura.

ESHTE NJE AKT I DHUNSEM AKTI QE NDIHET SI I TILLE NGA FEMRAT. Vetem ato munden ta dine se çfare ngacmimi, fyerjet, goditjet ose dhunimi shperthejne dhe shkaterrojne tek ato.

DHUNA NDAJ FEMRAVE ESHTE NJE PROBLEM I SHOQERISE. Pergjegjesia hidhet shpesh mbi viktimat: « Je ti, me siguri, qe ke provokuar gjithë ketel! ». Edhe viktimat vete arrijne te dyshojne tek vetja dhe ndihen fajtores : « Une nuk duhej te kisha pranuar qe ta shoqeroja tek ai! ». Por te duash shoqerine e te tjereve nuk justifikon dhunimin! Nje fund i shkurter nuk justifikon ngacmimin seksual! Nje zenie nuk justifikon goditjet ne fytyre!

*Dhuna ndaj femrave
eshte nje problem
i shoqerise*

« *Eja! Mos
e bej
legjende!* »

ASGJE NUK JUSTIFIKON DHUNEN. Femrat nuk e kane rrezikun vetem ne rruge dhe ne stacionet bosh te trenit.

Perkundrazi, eshte ne jeten e tyre private, ne gjirin e çiftit te tyre, qe femrat jane shpesh te keqtrajtuara ne menyre sistematike. Dhe ky fenomen ka te beje me te gjitha klasat sociale.

Shpesh, burrat e dhunshem jane burrat « normale », pa probleme, qe nuk paraqesin asnje veshtiresi te dukshme ne planin personal, profesional ose shoqeror. Jashte familje, pjesa dermuese e ketyre burrave dine te japin nje imazh te pelqyeshem : komshiun e gjindshem, kolegun e kendshem, mikun e angazhuar ne planin shoqeror !....Por ne shtepi ata godasin, poshterojne dhe dhunojne per te treguar se jane ata me te fortit, per te dominuar partnerin e tyre ose mbase ata nuk kane mesuar te zgjidhin ndryshe konfliktet e tyre. Shpesh kjo dhune ne gjirin e çiftit nuk ben te dyshojne fare te afermit dhe miqte.

FYTYRAT E SHUMELLOJSHME TE DHUNES NDAJ FEMRAVE.

KJO NDODH NE TRANSPORTET PUBLIKE. Ai eshte ulur perballe saj, e shikon pa pushim. Ai kerkon shikimin e saj dhe provon qe t'a beje te reagoje.

Jo rehat, ajo kthen shikimin dhe provon qer ta injoroje ngacmimin

KJO NDODH NE DHOMEN E GJUMIT. « Dy here ne jave, eshte detyra bashkeshortore. » Keshtu ajo permend faktin qe i shoqi e dhunon prej vitesh.

KJO NDODH NE DARKE. Profesori kenaq te ftuarit: "Gruaja ime eshte bere nje intelektuale e vertete, edhe ajo: lexoi nje liber!", tallet ai ne pranine e saj.



« *Dy here ne
jave eshte
detyra bashke
shortore* »

KJO NDODH NE SHTEPI. "Une doja qe t'i tregoja se kush komandon ketu", thote ai. Kur ajo ka guxuar qe t'i kerkoje me shume leke per qeverisjen e familjes, ai e ka goditur ne fytyre.

KJO NDODH NE TELEFON. Ajo merr thirrje jo morale qe perseriten. Keto thirrje provokojne tek ajo nje ndjenje neverie dhe ankthi. Elle nuk ndjehet me ne siguri as ne shtepine e saj.

KJO NDODH NE PUNE. « ne qofte se ju jeni pak me shume e sjellshme me mua, une do te mundja, nga ana ime qe te beja diçka per ju », i thote superiori vartesis duke i vene doren ne qafe.

NE LUKSEMBURG,
ME SHUME SE 950 FEMRA DHE FEMIJE KANE KERKUAR STREHE NE
NJE SHTEPI PER GRA NE VITIN 2004.

CIKLI I DHUNES BASHKESHORTORE

Pjesa dermuese e femrave qe kane te bejne me kete fenomen nuk e humbin shpresen qe te shohin situaten e tyre te permoresohet serish.

Por shpesh kjo shprese duket mashtruese!

Ne fakt çiftet jane futur ne nje rreth vicioz duke mos qene ndoshta te vetedijshem. Shpesh, gjithçka fillon ne nje menyre qe nuk te vret. Vetem shume me vonë, femrat kuptojne se problemet ishin aty perpara te parit « hap te gabuar », pellembes se pare.

FAZA 1:

Eksperienca na ka treguar se disa sjellje tipike shenojne shpesh fillimin e ciklit te dhunes :

- > _____ « Sikur te kalonim nje mbremje te qete tek ne, te dy? », propozon ai çdo here qe ajo ka takim me shoqen e saj. Gjithmone e me shpesh ajo heq dore nga miqte e saj.
- > _____ Ai behet xheloz dhe shikon rivale kudo. Per ta kenaqur, ajo kthehet direct pas pune.

« *Ti vetem shendoshesh!* »

> _____ Ai nuk don familjen e saj. Fillimisht, ajo shkon tek familja e saj vetem fare, por pak nga pak ajo i shikon ghithmone e me rralle njerezit e saj.

Gjithmone e me shume ai ushtron mbi jeten e saj nje kontroll te vertete dhe ajo pak nga pak largohet nga familja dhe miqte e saj.

FAZA 2:

Ai nuk kerkon me ne menyre te sjellshme : ai kerkon me ngulm ! Ai kritikon gjithçka. Fjalet qe ai thote dhe toni me te cilin ai i thote plagosin gjithmone e me teper..

- > _____ Kur behet fjale per punet e shtepise("Ti nuk di as te gatuash!") ose per edukimin e femijeve("edhe me ato, ti nuk arrin dot qe te jesh e respektuar!"), ai nuk eshte kurre i kenaqur.
- > _____ Ai kritikon paraqitjen e saj te jashtme("Ti vetem se shendoshesh!") ose ai ageson intimitetin e saj(" une nuk kam patur kurre partnere me kot ne krevat sesa ti!")
- > _____ Ai kerkon qe te lendoje, rregullisht ndjenjat e saj dhe kerkon qe ta nenshtroje.

Ajo nuk mbrohet me. Poshterimet fillojne te japin frytet e tyre. Ajo nuk don dhe nuk respekton me as veten e saj.

CIKLI I DHUNES BASHKSHORTORE

Faza 3:


Mundet qe ajo te mos kete pasur dhembje. Megjithate goditja e pare eshte nje perplasje e vertete. Ai e ka goditur sepse ajo eshte kthyer pak me vonë nga puna ose ai eshte nxehur shume pasi ajo ka guxuar ta kundrshtojte...

Faza 4:

Te nesermen ne mengjes, atij i vjen keq per « hapin e tij te gabuar ».

- > _____ Atij i vjen turp. I kerkon falje gruas se tij, I jep lule: "Kjo nuk do te arrije me kurre! Une isha me te vertete shume i nxehur!"
- > _____ Ai kerkon te shpjegoje perse nuk ishte vertete faji i tij : ne pune, shefi e ka stresuar; ne shtepi femijet e nervozojne... atehere ai nuk e ka duruar dot qe ajo te zgjedhur pikerisht kete dite per te diskutuar!
- > _____ Ai tregohet burri me i mire. Ata kuptohen perseri mire bile ato jane edhe te lumtur per disa kohe.





« *Kjo nuk do te ndodhe kurre me! Une isha me te vertete shume i nxehur!* »

Megjithate rruga u hap. Eksperienca na tregon qe pjesa me e madhe e burrave qe kane goditur grate e tyre nje here, do te vazhdojne qe ta bejne.... n.q.s ndonjeri nuk do t'i pengoje !

Nje here te ndodhe, cikli i dhunes do te vazhdoje te perseritet : nje mije here, ai do te premtroje qe ai do te ndryshoje, por nje mije here ai megjithate do ta godase, per arsye gjithmone e me te kota dhe gjithmone e me me pak ndergjegje.

DHUNA : NJE RRETH VICIOZ

Pare nga jashte, mundet te duket e pakuptueshme perse shume gra durojne sjelljen e dhundhme te burrit te tyre pergjate shume vitesh.

Gruaja ka shpesh idene se situata eshte pa shprese :

- > _____ Ne momentin kur gruaja vendos te nderprese mardheniet, disa kercenime shtohen : frika qe burri tenton te mos ta lejoje te shohe femijet e saj, frika e raprezaljeve kunder asaj vete, femijeve te saj ose te afermve, kercenimi per vetvrasje i burrit....
- > _____ Ne qofte se ajo eshte e varur financiarisht nga burri, pengesat materiale (mungesa e burimeve ekonomike,nevoja per te gjetur nje strehe dhe nje pune...) asaj i duken te pakalueshme.
- > _____ Dhuna eshte tashme nje realitet i perditshem.
- > _____ Ajo vazhdon te ndjehetpergjegjese e harmonise ne gjirin e familjes dhe mendon qe eshte per faj te saj qe ka zenka. Ajo ka gjithashtu nje problem tjetër, qe te mos privoje femijet e saj nga babai i tyre per aq kohe sa dhuna nuk i ve ato ne rrezik.



*Ajo ndjehet
e vetmuar me
shume se
kurre.*

- > _____ Ajo beson se ka deshtuar. Ajo ka turp dhe nuk guxon me qe te flase me miken e saj me te mire ose me familjen e saj. Ajo ndjehet e vetmuar me shume se kurre.
- > _____ Ajo eshte ne nje situatë izolimi shoqëror ekstreme dhe nuk ka pra rastin me te kerkoje ndihme per kete.
- > _____ Ajo eshte e ekspozuar ndaj presioneve te jashtme, si qortimi i rrethit te saj per shembull, qe preferon te qendroje tek burri per te shpetuar pamjen e jashtme. Keshtu nje grua qe kerkon t'i shpetoje dhunes se burrit te saj duhet, shpesh, ta beje e vetme kunder te gjitheve.
- > _____ Shpesh ajo nuk njeh as te drejttat e saj, as sherbimet e specializuara. Nga frika apo turpi, ajo nguron qe te kerkoje ndihme atje dhe nuk guxon qe t'i beje balle sistemit te drejtesise.

NE 2004, ME SHUME SE **1000** GRA KANE KERKUAR NJE SHTEPI PER GRA OSE NJE SHERBIM TE SPECIALIZUARKONSULTIMI PER TE MARRE INFORMACIONE OSE NDIHME NE RAPORT ME PROBLEMET E DHUNES NE CIFTIN E TYRE.

Josette (49 vjeçe), 2 femije te rritur

Pasi eshte rrahur edhe nje here me shume nga i shoqi, Josette ka shkuar direkt nga spitali ne shtepine e strehimit per gra.

Femijet e Josettes jane tashme te rritur dhe bejne jeten e tyre.

Qysh prej disa kohesh, ata keshillojne nenen e tyre qe te divorcohet. Ata nuk munden te kuptojne perse elle duron kete martir prej vitesh.

*Josette ka qene gjithmone grua shtepie, ajo nuk ka punuar kurre perkundrejt nje pagese. **Burri i saj e ka keqtrajtuar qysh prej fillimit, por nga momenti i ikjes se femijeve, sjellja e tij e dhunshme nuk njeh me limite.** Disa here Josette eshte shtruar ne spital nga brutaliteti i burrit te saj. Pas ketyre « hapave te gabuar », siç e quan ai kete sjellje te dhunshme, ai eshte gjithmone i sjellshem me Josette. Ai i ben asaj dhurata dhe e siguron qe gjithçka do te ndryshoje.*

Josette nuk i beson me premtimeve te tij. Prej shume kohesh ajo ka shpresuar me kot qe ai do te ndryshoje. Tani qe femijet bejne jeten e tyre ajo nuk ndihet me e detyruar qe “te ruaj kete celule familjare”.

Nje muaj pas mberritjes ne shtepine e strehimit per gra, ajo kerkon divorcin. Burri i saj provon shpejt qe ta pengoje me te gjitha mjetet. Por megjithese ajo nuk e di se çfare do te beje me te ardhmen e saj , Josette ka vendosur qe te mos kthehet me tek ai.

Anabella (28 vjeçe), 1 femije 10 muajsh

“per te paren here qe burri me ka goditur, ishte 6 muaj pas maltese dhe ai me ka qelluar shume fort. Une isha shtatzene 3 muajshe dhe ai me ka rrahur shume. Dhe arsyeja ishte sepse une i kerkova qe ai te fillonte te kerkonte pune. Une kam humour beben tim. Une doja atehere qe ta lija burrin tim, por ai dukej shume i trishtuar! Ai betohej qe nuk do te me godiste me kurre. Kam besuar vertet se ai do te ndryshonte. Doja qe t'i jepja perseri nje shans, qe kisha provuar gjithçka per te ruajtur

martesen to Gjashte muaj me vone, isha perseri shtatzene: Ai dilte shume vetem atehere: Ai kritikonte pamjen time fizike duke perdorur fjale fyese dhe ofenduese. Kur kthehej ne shtepi ne darke, ai me detyronte te ngrihesha e ti pergatisja per te ngrene: Ndonjehere me godiste...Ndjehesha thellesisht e poshteruar duke ruajtur shpresen se ai do te ndryshonte pas lindjes se femijes sone: Por ndoqa megjithate keshillen e nje mikeshes time dhe kam nje takim prane nje sherbimi informativ per gra.

Por nuk isha akoma gati te lija burrin tim. Ne muajin e tete te shtatezanise u nisa tek prinderit e mi. Burri telefonante çdo dite, ai me lutej qe te kthehesha prane tij e me premtonte se kurre ai nuk do te me godiste duke me kujtuar megjithate se ishte ai babai i femijes.

U ktheva tek ai dhe situata u permiresua: Ai dilte me pak, ka gjetur pune, dhe nuk nxebet me per nje po ose nje jo: Une kam me shume kurajo:

Por disa jave pas lindjes se djalit tone, gjithçka rifilloi . Bei nuk pushonte se qari . Burri me quante nene te keqe dhe i kalonte mbremjet ne kafe.

Situata u be e paperballueshme nje dite kur ai u kthye shume vone dhe bebi filloi te qaje, burri filloi te thyjeje e te me godase pa pike meshire:

Nje komshie thirri policine, qe me vendosi mua dhe bebin ne nje qender strehimi per gra.”

KJO NUK I ARRIN VETEM TE TJEREVE

Shume gra ndihen jo te lidhura me problemin e dhunes bashkeshortore dhe mendojne se kjo nuk ka per ti ndodhur kurre atyre. Por grate e keaqtrajtuara nga burri i tyre jane larg nga gruaja tip e dhunuar, grua shtepie, pa aktivitet profesional, qe rrjedh nga nje mjedis I defavorizuar, etj.

Mjetet e dhunes jane te holla,dinake. Diskutimet qe ekzistojne gjithmone ne nje çift-pasi behet fjale gjithmone me diskutuar interesat e njerit dhe tjetrit- mund te lekunden sipas disa kushteve. Situata mund te perkeqesohet atehere dhe perfundoje ne nje raport te pabarabarte dhe te dominimit.

Faktoret qe e nxisin mund te jene ndoshta nje shtatezani ose nje zhvendosje jashte shtetit, situata qe e bejne familjen me te dobet dhe te prekshme.

Ne parim asnje grua nuk mund te jete e sigurte te jete e mbrojtur nga ky fenomen shume me i perhapur nga ç` duket, ne format me pak te dukshme, si poshterimet dhe denigrimet sistematike. Ja pra perse duhet qendruar vigjilente.

Beini vetes te njejtat pyetje :

JENI JUVE VIKTIMA TE DHUNES BASHKESHORTORE BEINI VETES PYETJET E MEPOSHTME :

- > _____ Kritikon partneri juaj gjithë kohën trupin tuaj, veshjet tuaja, sjelljen tuaj, atë që ju thoni ?
- > _____ Ju kritikon ai ju para të gjithëve?
- > _____ Keni ju pershtypjen se nuk mundeni të shkoni për të parë prinderit ose miqtë tuaj pa kërkuar lejen e burrit tuaj ?
- > _____ Partneri, ju ofendon, ju thotë shpesh sharje dhe a ka ai ne përgjithësi një mendim të keq për femrën ne përgjithësi ?
- > _____ E ndjeni ju se çfarëdo që ju të bëni, gabimi është i juaji ?
- > _____ Veproni ju gjithmonë me kujdes nga frika se mos leshoni ndonjë zenkë ?
- > _____ Bashkeshorti juaj kërkon që të kontrollojë në vazhdimësi gjithçka që ju bëni, ku ju shkoni, me ke, perse, etj ?
- > _____ Burri juaj a është xheloz deri në atë pikë që nuk pushon se akuzuari se ju keni marrëdhënie me dikë tjetër, jashtë martesore ?
- > _____ Partneri juaj a ju ka kërcënuar se do t'ju bëjë keq, poashtu edhe femijëve tuaj ose të vetevritet në qoftë se ju e lini ?
- > _____ Partneri juaj a ju detyron që të keni marrëdhënie seksuale me atë edhe në qoftë se ju nuk doni ?
- > _____ Partneri juaj a ju ka kërcënuar se do t'ju godase?
- > _____ Partneri juaj a ju ka goditur tashmë?

Ne qoftë se ju i jeni përgjigjur positive njerës ose disave nga këto pyetje, mundet që ju të jeni viktime të dhunës bashkeshortore. Mos hezitoni që t'i drejtoheni një shërbimi konsultativ për gratë në mënyrë që ju diskutoni në qetësi për situatën tuaj me një profesionist.

SI T'IA DALESH MBANE?

Dhuna ne gjirin e nje çifti eshte nje rreth vicioz. Sa me shume te duroni poshterimet dhe goditjet, aq me shume do t'ju jete e veshtire per te gjetur nje mardhenie çifti te mire. Shpresa se kjo do te kaloje eshte veçse nje iluzion.

Nje burre qe ka goditur nje here do te godase perseri!

> _____ Kuptoni se keto kriza xhelozie mblidhen dhe se gjithçka duhet te shkoje sipas deshirave dhe vullnetit te tij; Bejini besim ndjenjave tuaja! Ato do t'ju thone se ka probleme ne mardheniet tuaja.

> _____ Gjithmone te dorezohesh nuk eshte zgjidhje. Provoni qe te imponoheni gjate nje konflikti.

> _____ Mos lejoni qe te ofendoheni. Kur ai ngul kembe vazhdimisht tek dobesite tuaja (« ti je shendoshur perseri ! »), nuk eshte rastesi : ai kerkon sistematikisht t'ju dominoje dhe te shkaterroje vleresimin qe ju keni per veten.

> _____ Kur ai behet i dhunshem : mos provoni qe t'ia dilni vetem. Mos heshtni nga frika apo turpi. Flitni me nje miken tuaj, kolegen familjen tuaj apo te tijen. Drejtohuni nje sherbimi konsultativ per gra.

> _____ Thoini atij se ju do te shkoni ne polici heren tjeter dhe mbi te gjitha bejini me te vertete! Mendoni gjithashtu te shkruani nje proces verbal nga agjenti i policise. Ne kete menyre heren tjeter do te jete e pamundur qe ai te thote se nje gje e tille nuk ka ndodhur kurre.

> _____ Parashikoni te beni nje denoncim dhe te merni nje avokat.

> _____ Kerkoni me ngulm atij qe ai te shkoje te takoje nje profesionist qe ta ndihmoje. Tentativat tuaja per te kuptuar arsyet e sjelljes se tij (« çfare mund t'a kete irrituar ne kete pike ») nuk do te mjaftojne te zgjidhin problemin. Ai duhet te mesoje te zgjidhe konfliktet pad hune. As mos e menoni se ju mund te dilni nga cikli i violences pa ndihmen e nje profesionisti.

Divorci nuk eshte i mire .Por ne qofte se ju nuk shihni me shanse qe situata te perliresohet dhe qe ju keni frike edhe per jeten tuaj. Ka vetem nje gje per te bere : ju duhet te ikni. Ne qofte se ju nuk gjeni strehim prane miqve ose te afermve, drzejtohuni nje sherbimi consultativ per gra ose ne polici ne menyre qe te gjeni nje shtepi strhuese per gra qe do te mund t'ju prese perkohesisht. Edhe pse kjo ju duket e pamundur sot : **ju do t'ia arrini te merni jeten tuaj ne dore.**

Ngacmimi i perditshem

- > _____ Ne qofte se nje burre ju thote gjera te turpshme,
- > _____ Ne qofte se pronari ju prek ne nje menyre jo normale,
- > _____ Ne qofte se komshiu nuk pushon me propozimet e tij,
- > _____ Ne qofte se nje burre ju bezdis ne telefon ,

ATEHERE

- > _____ Mos e quani veten fajtores !

Ne qofte se nje burre behet i pasjellshem dhe ngjites, eshte ai vete pergjegjes i sjelljes se tij. Sjellja juaj ose veshja juaj, edhe pse pak ekstravagante, nuk i japin te drejte asnjërit qe t'ju ngacmoje.

- > _____ Jini aktive !

Mos pranoni rolin e viktimes. Reagoni ! Shkoni para dhe tregoini vendin ketij burri. Vershelleni ne telefon, per te shokuar burrin qe ju ngacmon. Kur ajo eshte e ngacmuar gruaja ka plotesisht te drejte qe te mbrohet me nje menyre qe jep rezultate, qofte edhe te ashper, megjithese kjo nuk eshte nje sjellje « femeror ».

- > _____ Kerkoni aleate !

Ne qofte se kjo ndodh ne rruge, kerkoni ndihmen e kalimtareve. Ne qofte se kjo ndodh ne pune, tregojini kolegeve, kerkoni ndihmen e te deleguarit te sindikates ose te personelit ...

DHUNA NUK ESHTË NJË ÇESHTJE PRIVATE !

> _____ OFRONI NDIHMEN TUAJ

Kur nje grua ngacmohet ose sulmohet. Por mos merni shume rrezik persiper duke nderhyre per shembull. Ofroni ndihme ne distance ne qofte se duhet,por bejeni ! Ne kete menyre, ju do ti thoni agresorit dhe viktimes se dhuna nuk eshte nje ceshtje private. Shkoni kerconi ndihme.

> _____ MOS MBYLLNI SYTE

Kur shoqja jote, komshija ose kolegja keqtrajtohen. Jini te kujdesshem me shenjat alarmuese. Fakti qe nje grua ndryshon sjellje, behet e rezervuar, pin pije alkalike ose ilace mund te jete pasoje e nje keqtrajtimi. Pas syzeve te diellit ose rrobave me minge te gjata mund te fshihen plage te renda. Tregoini asaj qe ajo mund te kete besim tek ju. Ofroini asaj ndihme,por duhet te jeni e pergatitur qe ajo nuk do te flase mbase direct.

> _____ MOS LUANI SHURDHEN

Kur nje grua te ben te kuptosh se ekzistojne probleme ne çiftin e saj. Besoni çfare ju thote ajo ! Mos bej ate qe e dinte : « Kjo do te arrinte ! ». Mos e qortoni : « po perse ia lejon ti vetes ». Nga ana tjetër ju nuk duhet ta mbysni gruan mes keshilla. Mos i thoni se çfare ajo duhet te beje, kur te niset ose jo. Mos i propozoni qe ju te shkoni te shihni burrin per te rregulluar gjerat .



*Dhuna eshte
nje mjet
dominimi*

Degjojeni ate dhe jepini vlere asaj qe ajo ju thote pa e gjykuar. Transmetoini atij qartesisht mesaget e meposhtme :

- > _____ Ajo nuk eshte shkaku i dhunes.
- > _____ Ajo nuk eshte per tu qortuar.
- > _____ Ajo nuk eshte budallaqe.
- > _____ Ajo nuk eshte e vetme.
- > _____ Ajo nuk mund te ndryshoje sjelljen e burrit te saj.
- > _____ Dhuna nuk eshte humbje gjakftohtesie por mjet per te dominuar.
- > _____ Te kerkuarit falje dhe premtimet e agresorit nuk dota ndalin dhunen.
- > _____ Dhuna kundrejt bashkeshortes eshte gjithmone nje akt kriminal.

Dhuna nuk falet kurre. Çdo burre ka gjithmone zgjedhjen per te mos perdorur dhunen ! Parashikoni me gruan alternativa qe ju paraqiten dhe ndihmojeni ate qe te parashikojte masa sigurie per te dhe per femijet. Jepini asaj kohen e duhur per te marre vendimet e saj. Respektoni nevojen e saj per te ruajtur sekretin per situaten e saj.

LIGJI I 8 SHTATORIT 2003 MBI DHUNEN SHTEPIAKE

SIPAS LIGJIT.

Prej date 1 nentor 2003, ligji bmi dhunen shtepiake ka hyre ne fuqi.

Ne qofte se ju jeni te kercenuar ose te keqtrajtuar nga nje person i afert me te cilin ju bashkejetoni:


KONTAKTONI POLICINE NE NUMRIN 113

Mbi baze e te dhenave. Policia me lejen e prokurorit te shtetit expulsion personin nga shtepia.

Kohezgjatja e kesaj mase largimi eshte 10 dite.

Gjate kesaj periudhe, i ndalohet ketij personi te hyje ne shtepi, ne te kundert do tre kete sanksione penale (artikulli 439 i kodit penal)!

Policia merr çelesat qe japin mundesi te hysh ne shtepi ose ne ambiente qe varen nga ajo.



Ne rast largimi policia shkruan nje proçes verbal.

Nje kopje e ketij proçes verbali ju jepet juve.

Policia ose gjykata informojne sherbimin qe ndihmon viktimat e dhunes shtepiake ne lidhje me masen e largimit.

Ky sherbim eshte krijuar ne kuadrin e ligjit mbi dhunen shtepiake.

Objektivi eshte te asistohen, udhehiqen dhe te keshillohen personat viktime te dhunens shtepiake, duke kerkuar aktivisht kontaktin e tyre.

PJESE NGA LIGJI I 8 SHTATORIT 2003 MBI DHUNEN SHTEPIAKE

ARTIKULLI 1. : "NE KUADRIN E MISIONEVE TE PARASHIKIMIT TE SHKELJEVE DHE MBROJTJES SE PERSONAVE, POLICIA, ME LEJEN E PROKURORIT TE SHTETIT, LARGON NGA SHTEPIA E TIJ PERSONAT KUNDREJT TE CILEVE KA TREGUES QE ATO PO PERGATITEN TE SHKAKTOJNE NDAJ PERSONAVE ME TE CILET ATO BASHKEJETOJNE NJE SHKELJE LIGJI QE KA TE BEJE ME INTEGRITETIN FIZIK OSE ME JETEN, OSE QE ATO PERGATITEN TE RIBEJNE KUNDER PERSONAVE QE JANE TASHME VIKTIMA, PRA RIPERSERISIN.

PASTAJ?

Qysh ne momentin kur masa e largimit eshte ndermare, sherbimi i ndihmes ju kontakton me shkrim ose me telefon.

Ky sherbim ju informen mbi te drejtat tuaja dhe mbi veprimet e mundshme.

Ju keni 10 dite per te kerkuar tek kryetari i Gjyqit nje ndalim kthimi ne shtepi per personin e larguar.

Kjo mase eshte e vlefshme per nje periudhe maksimale 3 muaj dje kjo ne menyre te pavarur nga e drejta e pronesise dhe banimit de ketij personi.

NE DISA RASTE, GJYQI MUND TE JAPE DHE MASA ANESORE:

- > _____ ndalim me marre kontakt
- > _____ ndalim me u afruar
- > _____ ndalim me shkuar ne disa vende
- > _____ ndalim me strehuar femijet

GJATE VITIT TE PARE (01.11.2003-31.12.2004)

- > _____ 181 MASA LARGIMI
- > _____ 276 FEMIJE KANE TE BEJNE ME KETO MASA

KUJT TI DREJTOHEMI

_____ **Telefon per gra :** (e hene- e enjte 09-17)
_____ **Policia :** (24 ore)
_____ **Sherbimi urgjent :** (24 ore)

_____ **Tel: 123 44**
_____ **Tel: 113**
_____ **Tel: 112**

Sherbim informacioni dhe konsultimi per femra:

GRA NE FATKEQESI ASBL :

> ZYRA E INFORMACIONIT DHE KONSULTIMIT PER GRA

1, RUE DUCHSCHER	L-1424 LUKSEMBURG
12, RUE DE L'ALZETTE	L-4010 ESCH/ALZETTE
18, AV. J.-F. KENNEDY	L-9053 ETTTELBRUCK
KONSULTIM ME R.-V.	TEL.: 49 08 77

KESHILLI KOMBETAR I GRAVE LUKSEMBURGEZE :

> STREHA E JUGUT

10, RUE DE L'ÉGLISE	L-4002 ESCH/ALZETTE
23, GRAND-RUE	L-4575 DIFFERDANGE
KONSULTIM ME R.-V.	TEL.: 54 57 57

FONDACIONI SHTEPIA E PORTES SE HAPUR

> QENDRA OZANAN

64, RUE MICHEL WELTER	L-2730 LUKSEMBURG
TEL.: 48 83 47	FAX.: 40 97 87

Sherbimi i ndihmes se viktimave te dhunes shtepiake:

GRA NE FATKEQESI :

> SAV

B.P. 1024	L-1010 LUKSEMBURG
TEL.: 26 48 18 62	FAX.: 26 48 18 63

KUJT TI DREJTOHEMI

_____ **Telefon per gra :** (e hene- e enjte 09-17)

_____ **Policia :** (24 ore)

_____ **Sherbimi urgjent :** (24 ore)

_____ **Tel: 123 44**

_____ **Tel: 113**

_____ **Tel: 112**

Shtepi strehimi per gra ne Luxembourg (24 ore e hapur)

KESHILLI KOMBETAR I GRAVE LUKSEMBURGEZE :

> STREHA E JUGUT

B.P. 189

L-4002 ESCH/ALZETTE

TEL.: 54 57 57

FAX.: 53 06 61

FGRA NE FATKEQESI :

> SHTEPI PER GRA LUKSEMBURG

B.P. 1024

L-1010 LUKSEMBURG

TEL.: 44 81 81

FAX.: 29 30 80

> SHTEPI PER VAJZA

1, RUE DUCHSCHER

L-1424 LUKSEMBURG

TEL.: 29 65 65

FAX.: 49 41 49

FONDACIONI SHTEPIA E PORTES SE HAPUR

> STREHA PAULA BOVE

38-40, RUE D'ANVERS

L-1130 LUKSEMBURG

TEL.: 49 10 17

FAX.: 40 98 17

> HÔTEL MATERNEL

38-40, RUE D'ANVERS

L-1130 LUKSEMBURG

TEL.: 40 54 38 / 49 10 17

FAX.: 40 98 17

> STREHA SICHEM

2, RUE CHARLES RAUSCH

L-7247 WALFERDANGE

TEL.: 33 25 96

FAX.: 33 62 20

> SHTEPIA EDITH STEIN

20, DUERFSTROOSS

L-9651 ESCHWEILER/WILTZ

TEL.: 26 95 00 40

FAX.: 26 95 09 10

FONDACIONI PER FAMILIEN:

> QENDRA BETLEHEM

5, ROUTE DE ZOUFFTGEN

L-3598 DUDELANGE

TEL.: 51 72 72

FAX.: 52 21 88

NOÉMIE ASBL. :

L-4280 ESCH/ALZETTE

TEL.: 54 01 77



KESHILLI KOMBETAR I GRAVE
LUKSEMBURGEZE A.S.B.L

GRA NE FATKEQESI A.S.B.L

FONDACIONI SHTEPIA E PORTES SE HAPUR

FONDACIONI PER FAMILJEN

NOEMI A.S.B.L.

NE BASHKEPUNIM ME MINISTRINE E
BARAZISE SE SHANSEVE

Luksemburg, 2005

Subvencionuar nga Ministria e Barazise se Shanseve

rose de claire, design

Kjo ndodh ne transportet publike. IAi eshte ulur perballe saj, e shikon pa pushim. Ai kerkon shikimin e saj dhe provon qe t'a beje te reagoje. Jo rehat, ajo kihen shikimin dhe provon qer ta injoroje ngacmimin. Kjo ndodh ne dhomen e gjumit. "Dy here ne jave, eshte detyra bashkeshortore ." Keshtu ajo permend faktin qe i shoqi e dhunon prej vitesh Kjo ndodh ne darke. Profesori kenaq te stuarit: "Gruaja ime eshte bere nje intelektuale e vertete , edhe ajo: lexoi nje liber!", tallet ai ne pranine e saj. Kjo ndodh ne shtepi. "Une doja qe t'i tregoja se kush komandon ketu", thote ai. Kur ajo ka guxuar qe t'i kerkoje me shume leke per qeverisjen e familjes, ai e ka goditur ne fytyre. Kjo ndodh ne telefon. Ajo merr thirrje jo morale qe perseriten. Keto thirrje provokojne tek ajo nje ndjenje neverie dhe ankibi. Elle nuk ndjebet me ne siguri as ne shtepine e saj. Kjo ndodh ne pune. " ne qofte se ju jeni pak me shume e sjellshme me mua, une do te mundja, nga ana ime qe te beja dicka per ju", i thote superiori vartesis duke i vene doren ne qafe.

